

VENDIM
Nr. 159, datë 4.10.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR
PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË TË DHËNAVE DHE PROCEDURËN PËR AKSESIN
E FURNIZUESVE NDAJ TË DHËNAVE TË OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draftrregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE përcakton formatin e të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj këtyre të dhënave.

- Në bazë të nenit 69 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, operatori i sistemit të shpërndarjes i siguron pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike, akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti